




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 706/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paqarizi- Referues, z.,Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i OE-ve “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë” kundër njoftimit për dhënie të kontratës,ku për kontratë është rekomanduar OE-“NNSH Xhema Comlidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Realizimi i kyçjeve individuale shtëpiake dhe Komerciale për fshatrat: Dobrajë e Madhe, Llugë dhe Gllanicë” me numër të prokurimit :613-18-7967-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK Lipjan”, më datën 27.12.2018 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e grupit të OE-ve “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë”lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Realizimi i kyçjeve individuale shtëpiake dhe Komerciale për fshatrat: Dobrajë e Madhe, Llugë dhe Gllanicë” me numër të prokurimit : 613-18-7967-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK Lipjan”.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Realizimi i kyçjeve individuale shtëpiake dhe Komerciale për fshatrat: Dobrajë e Madhe, Llugë dhe Gllanicë” me numër të prokurimit : 613-18-7967-5-2-1” te KK Lipjan dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të OE-ve “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 17.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 13.11.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit e eliminuar: 16.11.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, grupi i OE-ve “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë me dt: 09.10.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 11.10.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e grupit të OE-ve “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinës të pa bazuar.

Operatorët ekonomik ankues: “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinës palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.10.2018 me nr. 549/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Realizimi i kyçjeve individuale shtëpiake dhe Komerciale për fshatrat: Dobrajë e Madhe, Llugë dhe Gllanicë” me numër të prokurimit : 613-18-7967-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK Lipjan”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,58 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.10.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 09.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ve ankues: “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë” finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Gjatë hartimit të ekspertizës kam konstatuar se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar. Ku thuhet se është shkelur neni 69, pas vlerësimit tim rezulton se vetëm makineritë për prerjen e asfaltit nuk janë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme ndërsa për kamionin për transportin e dheut janë dorëzuar dëshmi në pajtim me dosjen e tenderit, i propozoj panelit që ankesa e OE të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Pretendimi i OE-ve ankues “Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë” se autoriteti kontraktues ka shkelur neni 6 LPP-së (ekonomiciteti dhe efikasiteti) sepse ka përjashtuar konkurrencën në mënyrë diskriminuese dhe i shkakton dëm buxhetit duke pamundësuar pjesëmarrjen e OE me oferta më të mira, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit, derisa ende nuk janë dorëzuar ofertat dhe nuk është bërë hapja e tyre, nuk mundet të thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së sepse ende nuk është shpërblyer me kontratë asnjë operator ekonomik i cili do të kishte çmime më të larta dhe jo ekonomike në raport me ofertat e tjera që hipotetikisht do të kishin çmime më të lira apo më ekonomike. Pra ende është fazë e hershme që të konstatohet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të kësaj dispozitat të LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se është shkelur Neni 69: Aftësia teknike dhe /ose profesionale Referenca përkatëse të munguara:

Operatori ekonomik NNSH “Xhema Com “ nuk ka dorëzuar referenca për punë të ngjashme OE NNSH “Xhema Com nuk ka paraqitë as një reference me punë të ngjashme në ujësjellës ashtu siç kërkohet në dosje të tenderit.

FTD 1. OE-ik duhet te ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar – punë të ngjashme ne në tri vitet eshkuara, para datës se publikimit të njoftimit për kontratë. vlera minimale 150,000.00 €.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues, është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar, ka konstatuar se tenderuesi i shpallur fitues NNSH “Xhema Com “, ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar ndërtime të rrjeteve të kanalizimit , të cilat janë më se të ngjashme me natyrën e punëve për këtë kontratë – punë të ngjashme ne në tri vitet e shkuara. Shih kontratat në tabelën në vijim për të cilata ka të bashkangjitur referencat përkatëse.

Nr.r.	Përshkrimi	Viti	Shuma €	Punëdhënësi
1.	Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimitfsh. Kraisht, Ribar i madh, Ribar i vogël. Poturofc, Torin, Dobraj e madhe dhe llugë	2015	49,345.40	Komuna e Lipjanit
2.	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Lipjanit	2015	5,418.40	Komuna e Lipjanit
3.	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, ne fsh Miren-faza e parë	2016	32,611.25	Komuna e Lipjanit
4.	Rregullimi i qeshmes-currelit dhe infrastrukturës për rrethnë Leletiq	2016	6,420.40	Komuna e Lipjanit
5.	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, ne Varigovc	2017	28,369.13	Komuna e Lipjanit
6.	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, ne fsh Jeta e re	2017	20,727.23	Komuna e Lipjanit
7.	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, ne fsh Miren-faza e dyte	2017	23,405.50	Komuna e Lipjanit
8.	Punimi i kanalizimit fekal te konvikti 8 deri te puseta e qytetit	2017	9,073.15	Komuna e Lipjanit
9.	Intervenimi në disa vendebanime me rastin e vershimeve	2016	6,125.36	Komuna e Lipjanit
	T o t a l :		181,495.84	

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i tenderuesit ankues është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se është shkelur Neni 69: Aftësia teknike dhe /ose profesionale

2. Paisjet teknike te munguara:

Makineritë e prerjes se asfaltit –nuk janë dorëzuar dokumente pronësie apo dokumente qiraje dhe nuk gjendet as ne liste te mjeteve;

Makineritë e saldimit te tubave – kontrata e blerjes e dorëzuar është pa dokumente doganore dhe përshkrimi nuk përputhet i qarte me foton e bashkangjitur;

Kamion për transportin e dheut –dokumentet e paraqitura tregojnë regjistrimin e automjetit te skaduar.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues, i. Makineritë e prerjes se asfaltit –nuk janë dorëzuar dokumente pronësie apo dokumente qiraje dhe nuk gjendet as ne liste te mjeteve, është pjesërisht i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar, ka konstatuar se tenderuesi i shpallur fitues NNSH “Xhema Com”, ka dorëzuar DUD-in doganor nr. R-2504 i dt 05.03.2013 për një kompresor.

Eksperti shqyrtues, lidhur më këtë pajisje (Makineritë e prerjes se asfaltit), rekomandon që AK në me qëllim të sqarimit të dokumenteve dhe dëshmi të paraqitura nga NNSH “Xhema Com”, mbështetur në Nenin 72 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) të Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të kërkojë nga Tenderuesi NNSH “Xhema Com” që të dorëzojnë dëshmi-informacione shtesë, për të kuptuar së pajisja e ofruar a është në pajtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues, ii. Makineritë e saldimit te tubave – kontrata e blerjes e dorëzuar është pa dokumente doganore dhe përshkrimi nuk përputhet i qarte me foton e bashkangjitur, është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar, ka konstatuar se tenderuesi i shpallur fitues NNSH “Xhema Com”, ka dorëzuar kontratën e shit-blerjes nga shitësi Vesel Sejdiu për makinën salduese, në emër të NNSH “Xhema Com” dhe është në pajtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, ku si dëshmi kërkohet OSE Kontratën/at e shit-blerjes.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues, iii. Kamion për transportin e dheut –dokumentet e paraqitura tregojnë regjistrimin e automjetit te skaduar., është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar, ka konstatuar se tenderuesi i shpallur fitues NNSH “Xhema Com”, ka dorëzuar dëshmi tre lloj kamiona me të cilët mund të bartet –transportohet dheu (kamion me vinç, kamion me kran, kamion kiper 2 dyer, rimorkio, kamioneta (2), në emër të NNSH “Xhema Com” dhe është në pajtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, ku si dëshmi kërkohet lejen e qarkullimit te pajisjes ne emer te kompanisë/ /operatorit ekonomik. Bazuar në dëshmitë e lartpërmendura, rezulton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pa qëndrueshëm, sepse në kërkesë

nga AK nuk është kërkuar leje valide (e regjistruar) e qarkullimit të pajisjes në emër të kompanisë/ operatorit ekonomik. Nëse i paraqitet nevoja tenderusi NNSH “Xhema Com”, e vazhdon regjistrimin e kamionit.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura, rezulton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është pjesërisht i bazuar, me qenëse në ankesën me Nr.706/18 të parashtruar nga OE “Hidro Project” shpk & Britkos Consulting Services “N.Sh Prishtinë, nga pretendimi se është shkelur Neni 69, për Aftësia teknike dhe /ose profesionale, rezulton se vetëm për Makineritë e prerjes së asfaltit –nuk janë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për ta vlerësuar se pajisja a është në pajtueshmëri me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit;

Përgjigje në Pretendim nr.3

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se është shkelur Neni 69: Aftësia teknike dhe /ose profesionale

3.Stafi profesional

Një Gjeodet i licencuar, i cili nuk është ing. i gjeodezisë por me titull Bachelor dhe nuk e plotëson këtë kushte të kërkuar në DT.

Kërkesa : Një (1) Gjeodet i licencuar, me përvojë minimum tri (3) vite;

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të dokumentacionin të dorëzuar, ka konstatuar se tenderuesi i shpallur fitues NNSH “Xhema Com”, ka dorëzuar dëshmi për Gjeodetin- Izjadin SYLA, në pajtim me kërkesën në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit :kopjen e diplomës, licencën profesionale valide, CV-në ku shihet përvoja e punës dhe kontratë për marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar).

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pa qëndrueshëm, sepse në kërkesën nuk kërkohet se çfarë diplome gjeodeti duhet të ketë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të miratohet e bazuar, njëherësh propozoj që aktiviteti i prokurimit, “Realizimi i kyçjeve individuale shtëpiake dhe komerciale për fshatrat Dobrajë e Madhe, Llugë dhe Gllanicë”. me nr. të prokurimit: 613-18-7967-5-2-1, numri i brendshëm: 613 018 090 521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues(AK) – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, të kthehet në RIVLERËSIM

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 14.11.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 14.12.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, Eksperti profesional, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Ahmetaj deklaroj:

Pajtohem me vendimin e ekspertit që të kthehet lënda në rivlerësim, një ndër pikat që eksperti shqyrtues ka refuzuar ankesën është për kamion për transportin e dheut që është me afat të skaduar të regjistruar kurse kamionët tjerë sipas ekspertit nuk i plotësojnë kushtet sipas dosjes së tenderit kurse në pikat tjera pajtohem me mendimin e ekspertit dhe kërkoj që lënda të kthehet në rivlerësim. Nuk ka dëshmi për liste të pajisjeve nuk ka dëshmi për prese të asfaltit

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z Sadiku deklaroj:

Në si AK nuk pajtohem që lënda të kthehet në rivlerësim në si AK jemi të obliguar në bazë të nenit 72 të kërkojmë informata shtesë pasi që OE ka ofruar dudin doganor e cila për komisionin vlerësues ka qenë dëshmi e mjaftueshme që e posedon OE atë mjet, të gjitha pretendimet e tjera janë të bazuara dhe kërkoj që të refuzohet ankesa e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se të dyja palët janë pajtuar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, të verifikojë dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet të cilat i konteston operatori ekonomik ankues ashtu siç u cek më lartë, më saktësisht të vërtetojë se OE i rekomanduar për kontratë ka i përmbush të gjitha kriteret e kontestuara nga OE ankues.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë në mënyrë efikase, më transparente dhe më të drejtë

të shfrytëzimit të fondëve publike, burimeve publike sidhetëgjitha fondëve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Lipjan

1x1 OE- "Hidro Projekt shpk & Britkos Consulting Services Nsh- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.